



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 21.16.1-2016-08

RAPORTI I AUDITIMIT

**PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikën e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësi i ekipit Shkëlqim Xhema dhe Anëtarët e ekipit Ajtene Llapashtica dhe Leonora Hasani, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Samir Zymberi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	14
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	29
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	30
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	33
Shtojca IV: Letërkonfirmimi	37

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 10/11/2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Si theksim të çështjes tërheqim vëmendjen tuaj për faktin që shpenzimet në vlerë 795,895€ të bëra nga Policia e Kosovës ishin buxhetuar dhe paguar gabimisht nga investimet kapitale. Opinionin jonë nuk është modifikuar për këtë çështje.

Për më gjerësisht shih Pjesën 1.2 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Falënderojmë Sekretarin e Përgjithshëm dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimi të Auditimit”

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e Ministrit – auditimi 2016**

Ministri ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se Policia e Kosovës (PK) kishte buxhetuar dhe paguar nga kode jo adekuate një pjesë të shpenzimeve të saj te investimet kapitale. Në tri (3) pagesa të testuara në vlerë totale 795,895€, kemi vërejtur që blerjet për njësi kishin vlerën nën 1,000€ madje edhe nën 100€, që për nga natyra i takonin kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Opinioni jonë nuk është i modifikuar për këtë çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri i Punëve të Brendshme është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Në kontekst të PFV-ve, nuk kemi asnjë çështje për të ngritur. Çështjet e ngritura në Memorandumin e Auditimit , të datës 20/12/2016, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga menaxhmenti.

Në draft PFV ishin të nevojshme disa korrigjime financiare për të cilat kemi dhënë sugjerime për të përmirësuar cilësinë e tyre. Pas sugjerimeve, MPB ka korrigjuar PFV-të para finalizimit të tyre, për të konfirmuar saktësinë dhe plotësinë e tyre si dhe për të konfirmuar aplikimin e të gjitha kërkesave të tjera për raportim.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë dhe e drejtë.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

1.3 Rekomandimet

Për çështjen e theksuar të baza për opinion, japim rekomandimin si në vijim:

Rekomandimi 1 Ministri në bashkëpunim më Drejtorin e PK-së duhet të sigurojnë se kanë marrë masat dhe veprimet e nevojshme për të përmirësuar gabimet e identifikuar në theksimin e çështjes. Në këtë aspekt, të ndërmerren veprimet e duhura që të gjitha shpenzimet të planifikohen drejtë në kategoritë përkatëse të tyre, në mënyrë që t'i shmangën keq deklarimeve të shpenzimeve në PFV.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për MPB-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollat. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit që plotësohet nga MPB siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Qeverisja në MPB në lidhje me llogaridhënien dhe cilësinë e raportimit menaxherial pasqyron një situatë pozitive. MPB së bashku me Agjencitë² në kuadër të saj, kanë plotësuar pyetësin e vet-vlerësimit. Ndërsa regjistri i rreziqeve ishte plotësuar nga MPB, mirëpo jo edhe nga agjencitë e saj ekzekutive (Policia e Kosovës, Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Inspektorati i Policisë së Kosovës).

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka realizuar 33 raporte të auditimit si dhe dy (2) me kërkesë për menaxhmentin, të cilat ofruan pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe efektivitetin e tyre.

² Policia e Kosovës (PK), Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), Inspektorati i Policisë së Kosovës (IPK)

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e MPB-së për vitin 2015, ka rezultuar me 17 rekomandime kryesore. Menaxhmenti i MPB-së ka ndërmarrë veprime për t'i adresuar çështjet e ngritura, megjithëse ende mbetet sfidë zbatimi i plotë i tyre.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, shtatë (7) rekomandime janë zbatuar, dy (2) janë në proces të zbatimit, ndërsa tetë (8) nuk janë zbatuar ende. Një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato shihni Shtojcën III.

Çështja 2 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

- E gjetura** MPB ka hartuar me kohë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e vitit 2015, mirëpo nuk kishte ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të tyre. Rekomandimet e pa zbatuara ndërlidhen me çështjet, si: vonesat në realizimin e projekteve, vonesë në ekzekutimin e pagesave, mungesë e zotimit të mjeteve me kohë, kontratat për shërbime të veçanta, mbajtja e pozitave me ushtrues detyre, monitorimi jo i mirë i subvencioneve, pritjet e gjata të automjeteve për servisim si dhe raportimi i obligimeve të papaguara.
- Rreziku** Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë me mos efikasitet të vazhdueshëm të kontrolleve dhe vështirësi në përmbushjen e objektivave.
- Rekomandimi 2** Ministri në bashkëpunim me Drejtorët e Agjencive duhet të zbatojnë një proces efektiv për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm, i cili përcakton kohën e synuar dhe zyrtarët përgjegjës për këtë. Procesi të rishikohet në vazhdimësi dhe të ndërmerren veprime shtesë ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

2.2 Pyetësoni i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetësor të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorit të vet-vlerësimit të MPB-së të dorëzuar në Ministri, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësorit.

Ne kemi përmbledhur konkluzionet tona për MPB-në të cilat së bashku më të gjeturat dhe konkluzionet e nxjerra në auditimet tjera do të konsolidohen në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të jap koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do ta jap gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për t'i mbështetur përpjekjet e MF-së në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë (5) komponentët e tij. Për pyetjet e shqyrtuara kemi vërejtur se:

- “Ambienti i kontrollit”, gjatë hartimit të dokumenteve strategjike, në diskutimet e planit të strategjisë përfshihet niveli i lartë drejtues i MPB/Agjencive, organizatat ndërkombëtare, dhe shoqëria civile. Kostoja është e përfshirë në strategji dhe është pasqyruar në planet e veprimit;
- “Menaxhimi i rrezikut”, MPB për dallim nga PK, AKSP dhe IPK ka nxjerr vendim për menaxhimin e rrezikut, ka filluar me proces të trajnimit dhe punimeve lidhur me menaxhimin, monitorimin dhe raportimin e rreziqeve të mundshme. Punëtorja ka qenë e organizuar nga UNDP³, e cila ishte në fazën finale të hartimit të regjistrit për menaxhimin e rreziqeve i titulluar Plani i integritetit 2017-2019;
- “Aktivitetet e kontrollit”, plani i prokurimit përgatitet në përputhje me disponueshmërinë e fondeve buxhetore të miratuara. Pas miratimit të buxhetit, MPB, PK, AKSP dhe IPK i përgatisin planet finale të prokurimit dhe të njëjtat i dërgojnë në AQP;
- “Informimi dhe komunikimi”, kjo bëhet përmes sistemit elektronik, si dhe përmes sistemit të SIMFK-së. Në çfarëdo kohe apo rrethane përgatiten raportet për secilën nga raportet e kërkuara. Raporti për ekzekutim të buxhetit përgatitet në baza javore, mujore, tremujore dhe vjetore; dhe
- “Aktivitetet e monitorimit”, monitorimi i progresit në arritjen e objektivave realizohet përmes takimeve të rregullta të Bordit të drejtorëve të MPB-së dy herë në muaj, si dhe përmes formës standarde të raportimit lidhur me aktivitetet e zhvilluara në drejtim të përmbushjes së objektivave. Monitorimi i progresit bëhet nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe i raportohet kryesuesit të Organizatës Buxhetore. Po ashtu bëhen raportimet e rregullta javore për progresin e aktiviteteve të zhvilluara në sistemin elektronik që funksionon në nivel të MPB-së. Në fund të vitit bëhet monitorimi i progresit lidhur me objektivat e arritura si dhe analizohen shkaqet në mos përmbushjen e tyre të cilat pasqyrohen edhe në raportin vjetor të punës të MPB-së.

³ United Nations Development Programme - Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara

Çështja 3 - Moszbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut – Prioritet i lartë

- E gjetura** Agjencitë ekzekutive në kuadër të MPB-së si: PK, AKSP dhe IPK ende nuk kanë krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të identifikimit dhe menaxhimit të rreziqeve, që identifikon pengesat e mundshme krahas përmbushjes së objektivave.
- Kjo reflekton mungesë të llogaridhënies tek menaxhmenti i lartë lidhur me menaxhimin e regjistrit të rreziqeve si dhe një mungesë njohurie brenda agjencive dhe departamenteve për rolet e tyre në ofrimin e mbështetjes për procesin e menaxhimit të rrezikut.
- Rreziku** Mos veprimi i agjencive në identifikimin e rreziqeve reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar brenda organizatës buxhetore, duke rezultuar me dobësi në procesin buxhetor si dhe në reduktimin e mundësisë që menaxhmenti të reagojë ndaj sfidave financiare me kohë që mund të ndërliiden me objektivat e saj.
- Rekomandimi 3** Ministri duhet të sigurojë që Drejtorët e Përgjithshëm të Agjencive kanë deleguar përgjegjësinë e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut dhe të sigurojnë raportim për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit MPB operon dhe sfidat me të cilat përballlet.

2.3.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Në kuadër të MPB-së veprojnë gjashtë (6) Agjenci Ekzekutive si: Policia e Kosovës (PK), Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), Inspektorati i Policisë së Kosovës (IPK), Agjencioni i Kosovës për Forenzik (AKF), Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME) si dhe Agjencioni për Regjistrim Civil (ARC). Tri prej tyre AKF, AME dhe ARC veprojnë në kuadër të buxhetit të MPB-së. Ndërsa PK, AKSP dhe IPK i dorëzojnë PFV-të e tyre në MPB e cila më pas i konsolidon si një tërësi. Lidhur me këtë, menaxhmenti i MPB-së kishte dizajnuar një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar.

Procesi i raportimit të brendshëm në MPB funksionon sipas zingjirit llogaridhënës dhe strukturës organizative. Lidhur me këtë, menaxhmenti mban takime të rregullta me të gjitha njësitë e saj, duke raportuar dhe diskutuar për të gjitha aktivitetet. Për këto, menaxhmenti ka një proces të rregullt të raportimit përmes sistemit elektronik duke filluar nga ato javore deri te raportimi vjetor.

Agjencitë Ekzekutive kanë strukturën e tyre organizative, menaxhuese dhe llogaridhënëse. Këto janë përgjegjëse për raportim, ku janë përcaktuar qartë si dhe janë aplikuar mënyrat dhe proceset e llogaridhënies dhe të raportimit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) është e organizuar në katër njësi të cilat veprojnë në kuadër të: MPB, PK, AKSP dhe IPK. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i raporteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja dhe sfida të ofruara nga një Komitet efektiv Auditimi.

Secila njësi në kuadër të auditimit të brendshëm ka hartuar planin strategjik dhe vjetor të tyre. Në tërësi janë planifikuar 33 auditime për vitin 2016, duke u fokusuar në fushat të cilat paraqesin rrezik të lartë. Këto njësi kanë kryer 33 raporte të auditimit si dhe dy (2) me kërkesë, duke përmbushur në tërësi planifikimin.

Në këto raporte, NjAB-të kishte dhënë 170 rekomandime konkrete lidhur me përmirësimin dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm. Prej tyre 99 ishin zbatuar, ndërsa 71 janë në proces të adresimit.

Komiteti i Auditimit (KA) kishte mbajtur pesë takime të rregullta në të cilat janë shqyrtuar gjetjet dhe rekomandimet e NjAB-së si dhe kishin diskutuar për mënyrën e adresimit të rekomandimeve.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit, të burimeve njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

MPB ka kontrolle në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Në vitin 2016, MPB ka përdorur 99% të buxhet final, realizim të njëjtë me vitin paraprak. Në këtë përqindje kanë ndikuar edhe vendimet e Qeverisë për reduktimin e fondeve në fund të vitit. Menaxhimi dhe raportimi i të hyrave është bërë në pajtueshmëri me legjislacionin. PK në disa raste ka aplikuar penale për Operatoret Ekonomik (OE) për vonesa në realizimin e projekteve.

Megjithëse, veprime shtesë nevojiten në realizimin e procedurave të prokurimit, në procedimin e lëndëve për pagesë dhe monitorimin e subvencioneve. Në disa raste pranimi i mallrave dhe shërbimeve është bërë në mungesë të zotimit të mjeteve, si dhe kishte vonesa në procesimin e pagesave. Po ashtu procesi i shpenzimit të buxhetit për investime kapitale ka shfaqë mos pajtueshmëri me planin e rrjedhjes së parasë, rreth 42% e buxhetit është shpenzuar në tremujorin e fundit të vitit.

Më tutje MPB dhe PK, kanë vazhduar me ushtrues detyre për periudha të gjata kohore, ndërsa punësimet me marrëveshje të veçanta kanë tejkaluar afatet e lejuara. Menaxhimi i pasurisë dhe raportimi i obligimeve të papaguara kanë nevojë të përmirësohen.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Të hyrat vetjake	891,129	933,458	44,692,833	43,201,460	45,790,159
Totali	891,129	933,458	44,692,833	43,201,460	45,790,159

Të hyrat e arkëtuara gjatë viti 2016 ishin 44,692,833€. Prej tyre nga ARC-ja ishin 40,981,334€, ndërsa nga PK ishin 3,711,499€. Nga të hyrat vetjake, 933,458€, janë lejuar të shpenzohen për nevojat e MPB-së, përkatësisht PK-së, nga të cilat janë shpenzuar 745,383€.

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ⁴	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	109,123,253	105,831,308	104,966,519	110,171,541	99,575,765
Granti i Qeverisë -Buxheti	108,232,124	104,886,955	104,221,135	108,994,018	98,537,898
Të hyrat vetjake ⁵	891,129	891,129	703,093	848,800	562,757
Të hyrat e bartura nga viti paraprak	-	42,329	42,291	327,520	469,348
Donacionet e jashtme	-	10,896	-	1,203	5,762

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 3,291,945€. Ky zvogëlim është rezultat i rishikimit buxhetor prej 2,604,869€ dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë vlera 687,076€.

Në vitin 2016, MPB-ja ka përdorur 99% të buxhet final ose 104,966,519€, me një shpenzim të njëjtë në raport me përqindjen e vitit 2015. Megjithatë, realizimi i buxhetit për investime kapitale mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	109,123,253	105,831,308	104,966,519	110,171,541	99,575,765
Pagat dhe Mëditjet	72,971,198	74,919,649	74,860,541	72,310,539	65,426,355
Mallrat dhe Shërbimet	18,161,845	18,566,860	18,227,575	21,798,547	19,656,660
Shërbimet komunale	1,886,500	1,909,249	1,771,634	1,686,099	1,559,003
Subvencionet dhe Transferet	2,071,867	2,341,196	2,152,044	2,600,735	900,249
Investimet Kapitale	14,031,843	8,094,354	7,954,725	11,775,620	12,033,498

⁴ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

⁵ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Te kategoria e pagave dhe mëditjeve, buxheti final në raport me buxhetin fillestar është rritur për 1,948,451€. Kjo rritje vjen si rezultat i vendimeve të Qeverisë;
- Rritja e buxhetit final për mallra dhe shërbime për 405,015€ në raport me atë fillestar është rezultat i rishikimit dhe vendimeve të Qeverisë. Me rishikim kishte zvogëlim të buxhetit për vlerën prej 1,453,739€. Pastaj rritje të buxhetit final prej 1,858,754€ me vendim të Qeverisë;
- Buxheti final për komunalitet është rritur për 22,749€ nga ai fillestar. Kjo vlerë fillimisht ishte rritur me rishikim të buxhetit për 100,000€, ndërsa pas rishikimit kishte zvogëlim 77,251€ me vendime të qeverisë;
- Buxheti final i subvencioneve ishte rritur për vlerën 269,329€ në raport me buxhetin fillestar. Kjo rritje vjen me rishikim të buxhetit 250,000€ si dhe me buxhet final 19,329€; dhe
- Buxheti final i investimeve kapitale ishte zvogëluar në raport me buxhetin fillestar për vlerën 5,937,489€. Fillimisht me rishikim të buxhetit ishte zvogëluar për 1,501,130€, pastaj me vendim të Qeverisë në buxhetin final ishte zvogëluar edhe për vlerën 4,436,359€.

Çështja 4 – Realizimi i buxhetit – Prioriteti i lartë

E gjetura	<p>Realizimi i buxhetit për investimet kapitale mbetet sfida kryesore me të cilën përballen MPB dhe PK. Në këtë periudhë janë shpenzuar 100% e buxhetit final mirëpo në raport me atë fillestar shpenzimi ishte vetëm 57%. Buxheti fillestar në atë final ishte zvogëluar për 5,937,489€.</p> <p>Për më tepër një pjesë e konsiderueshme e buxhetit për investime kapitale, ose 42% e tyre ishte shpenzuar vetëm në tremujorin e fundit të vitit. Ky shpenzim nuk është në përputhje me planin dhe rrjedhën e parasë.</p> <p>Arsyet për një ekzekutim të ulët përfshijnë vonesat në inicimin e procedurave të prokurimit, anulimet si dhe periudhat e gjata të realizimit të punëve.</p>
Rreziku	<p>Ekzekutimi i dobët i buxhetit, do të rezultojë me shfrytëzim joefikas të burimeve si dhe redukton efektivitetin e operacioneve të MPB-së dhe PK-së. Ndërsa, në anën tjetër fluksi i madh i shpenzimeve në fund të vitit rrezikon që pagesat t'i shmangen kontrolleve të duhura në proceset e ekzekutimit.</p>
Rekomandimi 4	<p>Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e PK-së duhet të sigurojnë realizim korrekt të buxhetit për investime kapitale. Bazuar në shkaqet e realizimit të ulët të buxhetit, të marrë veprime përmirësuese, ndërsa performanca buxhetore të monitorohet në baza të rregullta dhe të merren veprime kur është e nevojshme.</p>

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga MPB në 2016 ishin në vlerë 44,692,833€. Afro 92% e tyre ose 40,995,200€ janë inkasuar nga MPB-ja dhe agjencitë tjera, ndërsa 8% ose 3,697,633€ janë realizuar nga PK-ja.

Ne kemi testuar 50 mostra, përfshirë llojet e ndryshme të të hyrave, si: nga departamenti i sigurisë publike, nga qendra për regjistrimin e automjeteve, nga departamenti për prodhimin e dokumenteve si dhe nga të hyrat sekondare të PK-së. Bazuar në këtë vjëmë në përfundim se të hyrat janë inkasuar dhe raportuar në pajtueshmëri me Legjislacionin.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes sistemit të centralizuar. Kontrollët kyçe në këtë proces kanë dëshmuar plotësinë dhe saktësinë e të dhënave të prezantuara në PFV-të e MPB-së. Në këtë kategori janë shpenzuar 100% të buxhetit final (ref: tabela nr.3).

Çështja 5 - Plotësimi i pozitave me ushtrues detyrë më gjatë se tre muaj - Prioritet i lartë

E gjetura

Sipas Ligjit të Shërbimit civil, në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës (U.D) nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj. Ndërsa në PK, UA Nr. 07/2012 mbi marrëdhënien e punës e përcakton periudhën kohore për U.D. në kohëzgjatje deri në gjashtë (6) muaj me mundësi vazhdimi edhe për tre (3) muaj tjerë.

Nga testet e zhvilluara, identifikuam që 64 pozita vazhdojnë të mbulohen me U.D. si në vijim:

- Në MPB edhe më tej tetë (8) pozita po vazhdojnë të mbulohen me U.D, dy (2) prej tyre që nga viti 2014;
- Në ARC janë 10 pozita U.D, prej tyre një (1) nga viti 2008 si dhe dy (2) nga viti 2011;
- Në AME janë dhjetë (10) pozita me U.D, prej tyre katër (4) prej vitit 2011; dhe
- Në PK janë 36 pozita të mbuluara me U.D, prej tyre një (1) nga 2012, një (1) nga 2013, një (1) nga 2014 dhe tre (3) nga viti 2015.

Sipas Departamentit të Burimeve Njerëzore në MPB, problemi me sistemin informativ për menaxhimin e burimeve njerëzore i cili menaxhohet nga Ministria e Administrimit Publik (MAP) po ju pamundëson realizimin e procedurave të rekrutimit.

Ndërsa sipas zyrtarëve përgjegjës në PK-së ka mungesë stafi për këto pozita andaj nuk është arritur të zhvillohen procedurat e rregullta, si dhe MAP-i është vonuar në aprovimin e rregullores për organizimin e brendshme të PK, e nënshkruar më datën 31 janar 2017.

Për këto çështje ne kemi rekomanduar edhe në vitin e kaluar, mirëpo kjo praktikë mbetet edhe më tutje sfidë e MPB-së dhe PK-së.

Rreziku Avancimi, përkatësisht praktika e mbulimit të pozitave kyçe me U.D për periudha të gjata kohore përveç se nuk është në pajtueshmëri me legjislacionin rrezikon që pozitat të menaxhohen nga personat që nuk i përmbushin kriteret e nevojshme. Kjo mund të ndikojë negativisht në performancën e organizatës në përgjithësi.

Rekomandimi 5 Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e PK-së duhet të ndërmarrin veprime shtesë për të ndërprerë mbulimin e pozitave menaxheriale me U.D. Kohëzgjatja e funksionit si U.D të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar ligjore.

Çështja 6 - Ushtrimi i pozitave jo në përputhje me gradat aktuale - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas U.A Nr.07/2012 mbi marrëdhënien e punës në PK, me rastin e sistemimit të punonjësve apo caktimit në pozita të lira të punës duhet të përfillen kushtet-kriteret që parashihen për ato pozita. Sistemimit duhet t'i përgjigjet kualifikimi, grada, përvoja etj.

Gradat e pozitave në PK fillojnë prej: polic i ri, polic, polic i lartë, rreshter, toger, kapiten, major, nënkolonel dhe kolonel.

Në PK, 245 të punësuar të stafit policor ushtrojnë grada tjera prej atyre që aktualisht i kanë arritur. Prej tyre, 20 ushtrojnë më shumë se një (1) gradë deri në tri (3) grada. Sipas udhëzimit, për qëllime operative (në raste të caktuara) me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së mund të caktohen për një vend tjetër nëse plotësohen kushtet dhe kriteret e parapara. Megjithatë kjo duhet të rishikohet dhe caktimi në pozita të bëhet sipas gradave të fituara.

Rreziku Ushtrimi i gradave tjera duke mos kaluar nëpër procese të rregullta të sistemimit rrezikon që pozitat të menaxhohen nga persona që nuk i plotësojnë kriteret e nevojshme dhe ndikon në rritje të shpenzimeve.

Rekomandimi 6 Ministri në bashkëpunim më Drejtorin e PK-së duhet të sigurojnë që sistemimi i stafit policor në pozita të lira bëhet pas plotësimit të kriterëve dhe procesit të gradimit apo rekrutimit të rregullt brenda PK-së.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë edhe komunalitetë) në vitin 2016 ishte 20,476,109€. Prej tyre ishin shpenzuar 19,999,209€. Në kuadër të këtyre shpenzimeve ne kemi testuar 37 pagesa në vlerë 6,797,014€ si dhe nëntë procedura të prokurimit⁶ në vlerë 22,320,570€. Dobësitë e vërejtura gjatë testimit të tyre janë si në vijim:

Çështja 7 - Marrëveshjet për shërbime të veçanta pa procedura - Prioritet i mesëm

E gjetura Me Ligjin për shërbyesit civil nuk lejohet angazhimi përmes “Marrëveshjeve për shërbime të veçanta” më gjatë se gjashtë (6) muaj. Emërimet në raste të tilla do të bëhen duke ju nënshtruar Ligjit për Detyrimet, për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Në kuadër të MPB-së dhe Agjencive të saj gjatë vitit 2016 janë angazhuar 26 persona përmes “Marrëveshjeve për shërbime të veçanta” vlera e shpenzimeve të të cilave ishte 55,913€. Për këto marrëveshje nuk janë udhëhequr procedurat e thjeshtësuar të rekrutimit nga departamenti i burimeve njerëzore. Prej tyre, shtatë (7) ishin për një periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj, të cilët ende vazhdojnë në këtë mënyrë.

Për këto marrëveshje ne kemi rekomanduar edhe vitin e kaluar, por një praktikë e tillë vazhdon ende.

Rreziku Praktika e lidhjes së kontratave me marrëveshje për shërbime të veçanta, pa procedura të rekrutimit, nuk siguron konkurrencë dhe transparencë dhe shton rrezikun për përzgjedhjen e kandidatëve pa shkathtësitë dhe përvojat e duhura profesionale.

Rekomandimi 7 Ministri në bashkëpunim më Drejtorët e Agjencive duhet të sigurojnë se janë marrë veprime për të ndërprerë praktikën e angazhimeve të tilla në mungesë të procedurave, si dhe të evitohen pagesat e tyre në kundërshtim me ligjet.

⁶ Në këtë vlerë të procedurave përfshihen kontrata një vjeçare dhe kontrata kornizë deri në tre vite.

Çështja 8 – Zotimi i mjeteve pas pranimit të faturave - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas rregullave të Thesarit, fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procedohet urdhër-blerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa në fjalë. Në pesë (5) pagesa vërejtëm se zotimi i mjeteve dhe urdhërblertet ishin bërë pas pranimit të faturës, si:

- Në pagesën mirëmbajtje e pajisjeve në vlerë 11,203€;
- Në tri (3) pagesa për furnizim me derivate në vlerë 606,204€; dhe
- Në pagesën furnizim me veshmbathje në vlerë 121,858€.

Sipas zyrtarëve të financave, alokimi i mjeteve ishte bërë me vonesë, e që si pasojë janë vonuar në nxjerrjen e zotimeve dhe shlyerjen e obligimeve.

Rreziku Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme do të rezultojë në vonesa të zbatimit të kontratës dhe rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues. Derisa pranimi i mallra dhe shërbime para se te përcaktohen kërkesat/nevojat, mund të rezultojë që të pranohen mallrat të cilësisë dhe sasisë jo të nevojshme.

Rekomandimi 8 Ministri duhet të sigurojë që kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave janë duke u monitoruar në vazhdimësi. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPP-në, dhe me rregullat e Thesarit.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 2,341,196€. Prej tyre ishin shpenzuar 2,152,044€. Në këtë kategori kemi testuar pesë (5) pagesa në vlerë 198,934€.

Në MPB subvencionet ndahen për “Departamentin e Ri-integrimit të personave të Riatdhesuar” që kanë për qëllim kryesor të ndihmojnë dhe të mbështesin ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar. Ndërsa në PK, subvencionet realizohen kryesisht për kompensim material për përkrahjen shëndetësore të pjesëtarëve të PK-së (të lënduar në detyrë), si dhe për familjarët e personave të rënë në detyrë.

Lidhur me mënyrën e shpenzimit të subvencioneve ne identifikuar mangësitë si në vijim.

Çështja 9 - Mos funksionalizimi/realizimi i planeve të biznesit të subvencionuara nga MPB - Prioritet i lartë

E gjetura MPB në bazë të rregullores Nr 04/2016 për ri-integrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të ri-integrimit, neni 20 mbështet familjet apo personat e riatdhesuar përmes subvencionimit të planeve të bizneseve.

Gjatë viti 2016, MPB kishte subvencionuar 70 plane të biznesit për personat e riatdhesuar në vlerë 207,530€. Prej tyre, 26 plane të biznesit në vlerë 76,613€ apo 37% nuk ishin funksionale apo nuk janë realizuar sipas qëllimit të parashikuar.

Edhe përkundër monitorimit prej MPB-së, planet e bizneseve nuk ishin bërë funksionale dhe nuk ishin realizuar. Po ashtu, prej 60 planeve të bizneseve në vitin 2015 në vlerë 125,850€ të cilat është dashur të monitorohen për një periudhë 12 muajsh, vërejmë që 36 prej tyre në vlerë 75,048€, nuk janë realizuar.

Ajo që vlen të theksohet është numri i madh i aplikuesve të riatdhesuar për plane të biznesit. Në vitin 2016 MPB kishte aprovuar 615 plane të biznesit në vlerë 1,619,470€. Prej tyre janë deklaruar si obligime vetëm 886,060€ për 300 plane, ndërsa pjesa tjetër për 733,410€ për 315 plane nuk janë prezantuar si obligime. Për më tepër vlera e aprovimeve kishte tejkaluar mjetet buxhetore për subvencione.

Në një rast vërejtëm që personi i riatdhesuar në bazë të planit të biznesit ka marrë subvencion në vlerë 2,000€, por nuk e kishte shfrytëzuar për qëllimin e dedikuar. Kjo ishte konstatuar edhe në bazë të monitorimit të bërë nga ana e MPB-së.

Rreziku Shfrytëzimi jo i drejtë i subvencioneve nga përfituesit e riatdhesuar dhe monitorimi i dobët nga MPB-ja, rrit rrezikun që mjetet të mos shpenzohen në përputhje me qëllimin e synuar. Madje aprovimi i planeve në mungesë të mjeteve buxhetore do të ndikojnë në rritjen e obligimeve dhe shpenzimeve të paplanifikuara.

Rekomandimi 9 Ministri duhet të forcoj mekanizmat për menaxhimin më të mirë të subvencioneve, duke siguruar shfrytëzimin e drejtë të parasë për arritjen e qëllimit të synuar. Njëherit të sigurojë fonde të mjaftueshme buxhetore para aprovimit të vendimeve për subvencione.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale është 8,094,354€. Prej tyre janë shpenzuar 7,954,725€. Në kuadër të këtyre shpenzimeve ne kemi testuar 16 pagesa në vlerë 2,448,899€ si dhe shtatë (7) procedura të prokurimit në vlerë 1,041,458€. Bazuar ne testet tona shpалosëm mangësitë si në vijim.

Çështja 10 - Vonesë në realizimin e projekteve - Prioritet i mesëm

E gjetura Në MPB dhe PK në katër (4) pagesa në vlerë totale 313,420 €, kemi vërejtur vonesa në realizimin e projekteve kapitale nga operatorët ekonomik. Këto vonesa ishin për projektet si në vijim:

- “Renovimi i objektit të ish Administratës të PK-së” ishte paraparë të përfundojë brenda 95 ditëve kalendarike, mirëpo ishte vonuar 245 ditë kalendarike nga koha e paraparë me kontratë;
- “Ndërtimi i garazhës – tip i mbyllur në Kampin Vrella në PK” punët do të përfundonin brenda 80 ditëve kalendarike, mirëpo janë përfunduar 110 ditë pas afatit të kontraktuar. Menaxheri i projektit kishte arsyetuar këto vonesa, madje edhe ditët e diela edhe pse në kontratë koha ishte e përcaktuar me ditë kalendarike;
- “Avancimi i sistemit të menaxhimit të kufirit në PK” pjesa e parë e avancimit të sistemit, do të përfundonte brenda 274 ditëve kalendarike, duke filluar nga 13.01.2016. Mirëpo deri në fund të vitit edhe pse kanë kaluar 352 ditë kalendarike, ose 78 ditë vonesë, ishte finalizuar vetëm 80% e projektit. Kjo vonesë ishte si rezultat i pritjes së procedurave të vonuara të prokurimit për blerjen e pajisjeve që të finalizohet projekti në fjalë; dhe
- “Vazhdimi i ndërtimit të objektit të QKRC-QKRA në Gjakovë në MPB” ishte përcaktuar që plani dinamik për realizimin e punëve të jetë 120 ditë pune, duke filluar nga data 12.05.2016. Deri në fund të vitit mbas 233 ditë punë, ose 113 ditë vonesë, punët nuk kishin përfunduar. Madje kishte edhe pozicione të pa kryera sipas komisionit për pranimin teknik dhe menaxherit të kontratës.

Përkundër vonesave nga operatorët ekonomik nuk janë aplikuar ndëshkimet e parapara me kontratë.

Rreziku Dështimi për t'i përfunduar më kohë projektet e përcaktuara mund ta reduktojë efektivitetin e operacioneve të PK-së dhe do të rezultojë në dështim të arritjes së objektivave. Vonesat në realizimin e projekteve gjithashtu mund të rezultojnë në rritjen e obligimeve në fund të vitit, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi 10 Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të sigurojnë se janë forcuar edhe me tej kontrollet në proceset e planifikimit (analizë e pengesave të mundshme), monitorimit dhe realizimit të projekteve kapitale, në mënyrë që të respektohet afati për përmbushjen e kontratës.

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë paraqitur çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja 11 – Planifikim jo i mirë i vlerës së kontratave – Prioritet i mesëm

E gjetura Në PK gjatë testimit të dy kontratave të prokurimit kemi vërejtur që njësitë e kërkesës nuk kanë planifikuar drejt vlerat e kontratave. Si rezultat janë anuluar tenderimet/procesi i prokurimit për nevoja të buxhetit shtesë dhe klasifikimit të kontratës sipas vlerës.

Këto planifikime, të cilat kanë rezultuar me nënshkrim të kontratave me vlerë më të lartë janë si në vijim:

- Kontrata “Furnizim me pjesë rezervë për autobus të PK”, e ri tenderuar si rezultat i mungesës së mjeteve, ishte parashikuar në vlerën 120,000€ si vlerë e mesme e furnizimit. Ndërsa ishte nënshkruar si kontratë e madhe në vlerë 152,392€ pas aprovimit nga ZKF për mjete buxhetore; dhe
- Kontrata “Pajisje për kontroll të bagazheve, veturave dhe persona në PK”, e ri tenderuar si procedurë ishte planifikuar për tri (3) vite në vlerë 240,000€. Mirëpo, kontrata ishte nënshkruar për dy (3) vite në vlerë 307,408€ pas aprovimit për mjete buxhetore.

Në këto raste nuk janë hulumtuar në mënyrë të arsyeshme çmimet e përafërta të tregut nga njësia e kërkesës dhe prokurimi për të bërë planifikim të drejtë të nevojave dhe vlerave të kontratave.

Rreziku Mos hulumtimi i arsyeshëm i çmimeve dhe planifikimi jo i mirë i shpenzimeve rrezikon anulimet e shpeshta të procedurave të tenderimit, duke shmangur edhe procedurat e caktuara të llojeve të kontratave. Këto rezultojnë me mos shfrytëzim efikas të buxhetit dhe vonesë në shpenzimin e tij.

Rekomandimi 11 Ministri në bashkëpunim më Drejtorin e PK-së të sigurojnë që janë ndërmarrë masa që njësitë e kërkesës para inicimit të shpenzimeve kanë bërë një analizë të drejtë të nevojave dhe planifikim të mirë të buxhetit.

Çështja 12 - Nënshkrimi i kontratave pa zotim të mjeteve - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas rregullës financiare Nr.01/2013/MF shpenzimi i parave publike, asnjë kontratë nuk duhet të nënshkruhet pa zotim të gjeneruar nga SIMFK për vitin aktual fiskal.

Në PK kemi vërejtur që kontratat nënshkruhen pa zotim të mjeteve apo me zotime jo të plota. Këto janë vërejtur si në vijim:

- Kontrata “Furnizim me municion” në vlerë 573,950€, e datës 07.06.2016, nënshkrimi i saj është bërë pa zotim të mjeteve. Zotimi është bërë pas një muaji apo me datën 11.07.2016. Ndërsa vazhdimi i validitetit të tenderit dhe sigurisë së tenderit ishte bërë me vonesë, 14 ditë pas vendimit të OSHP-së; dhe
- Kontrata e nënshkruar me datën 03.06.2016 “Furnizim me licenca dhe programe kompjuterike” në vlerë prej 198,163€, zotimi i mjeteve që nevojitet para nënshkrimit të kontratës nuk është as i përafërt me vlerën e parashikuar vjetore të kontratës. Zotimi i bërë ishte në vlerë prej 9,000€.

Rreziku Nënshkrimi i kontratave pa siguruar fondet e nevojshme mund të rezultojë në vonesa të zbatimit të kontratës dhe rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi 12 Ministri në bashkëpunim më Drejtorin e PK-së duhet të sigurojnë kontrolle shtesë për të siguruar që kontratat nënshkruhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fonde që sigurojnë ekzekutimin e tyre.

Çështja 13 - Vonesë në nënshkrimin e kontratave - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas LPP, personat e autorizuar mund të nënshkruajnë kontratën vetëm nëse përmbushen kushtet vijuese, që së paku dhjetë (10) ditë kanë kaluar nga data e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës.

Në PK ne kemi vërejtur që prej njoftimit për dhënie të kontratës, nënshkrimi i tyre është vonuar deri në 147 ditë, pas periudhës 10 ditësh. Këto vonesa janë vërejtur te kontratat si në vijim:

- Furnizim me licenca dhe programe kompjuterike, në vlerë 198,163€, vonesa për nënshkrim është 147 ditë;
- Furnizim me pajisje dhe pjesë elektronike për IT - lloti 3 në vlerë 8,500€, vonesat janë 50 ditë; dhe
- Furnizim me ushqim për PK-në, në vlerë 1,558,848€, vonesa ishte 25 ditë.

Sipas zyrtarëve të PK vonesat janë për shkak se ministri monitoron tërë procesin deri te nënshkrimi i kontratës. Vlerësimi është se procesi i monitorimit duhet të jetë efikas përndryshe mund të sjellë efekte negative në shpenzimin e buxhetit.

Rreziku Vonesat e gjata me rastin e nënshkrimit të kontratave mund të shkaktojnë probleme me rrjedhën e parasë si dhe mos realizimin me kohë të projekteve të planifikuara të PK-së. Kjo reflekton në shpenzimin e buxhetit, e sidomos në pjesën e fund vitit.

Rekomandimi 13 Ministri në bashkëpunim më Drejtorin e PK-së duhet të sigurojnë që nënshkrimi i kontratave të bëhet sipas afateve ligjore duke mos u vonuar nënshkrimi i tyre. Kjo do të siguronte performancë më të mirë të aktiviteteve, realizim më të mirë të buxhetit dhe shmangie të pagesave në pjesën e fundit të vitit.

Çështja 14 – Vonesë në realizimin e pagesave – Prioritet i mesëm

E gjetura Rregulla Financiare Nr.01/2013/MF – përcakton se “të gjitha faturat që i pranon organizata buxhetore duhet të paguhen brenda 30 ditëve në qoftë se nuk është paraparë ndryshe me kontratë”.

Në dhjetë (10) pagesa në vlerë 1,099,645€, PK nuk ka arritur të kryejë pagesat në afatin e përcaktuar ligjor. Këto pagesa janë vonuar nga 2 deri në 116 ditë pas afatit 30 ditë për pagesë.

Kjo çështje ishte rekomandim edhe vitin e kaluar, mirëpo edhe përkundër zotimit të menaxhmentit nuk ishte zbatuar. Vonesat në realizimin e pagesave, ishin prej inicimit për pagesë deri te aprovimi i tyre.

Rreziku Vonesat në ekzekutimin e pagesave rrisin rrezikun për pagesa shtesë të dëmshpërblimeve ndaj OE. Kjo rrit rrezikun e dështimit të pagesave për mungesë të fondeve dhe bartjen e obligimeve në vitin pasues.

Rekomandimi 14 Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e PK-së duhet të sigurojnë mbikëqyrje të rregullt të procesit të ekzekutimit të buxhetit me qëllim që çdo faturë të paguhet brenda afatit të përcaktuar ligjor.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuria me vlerë mbi 1,000€ në MPB (përfshirë PK, AKSP dhe IPK) është 49,087,920€ ndërsa pasuritë në nën 1,000€ janë 4,381,526€. Ne kemi testuar 11 pasuri (mbi dhe nën 1,000€), me vlerën prej 1,265,947€.

Përveç testeve substanciale, ne kemi testuar edhe pasuritë që rrjedhin nga investimet kapitale të vitit 2016, si dhe pasuritë e pranuar si donacione. Për këto kemi kryer teste mbi ekzistencën e pasurive si dhe teste për të siguruar se regjistrat janë azhurnuar me të dhënat e reja.

Bazuar në këtë kemi identifikuar mangësinë si në vijim:

Çështja 15 - Pritjet e gjata të automjeteve që presin për servisim - Prioritet i lartë

E gjetura Në PK në tri (3) vitet e fundit kemi rekomanduar lidhur me pritjet e gjata të automjeteve për riparime. Mirëpo edhe përkundër zotimit të menaxhmentit për ta zbatuar këtë rekomandim edhe në vitin 2016, numri i automjeteve që presin për servise është shumë i lartë.

Në flotën e PK-së automjete ishin 161 automjete që presin për servisim dhe riparim për defekte të ndryshme. Pritjet ishin si në vijim:

- 12 automjete nga viti 2014;
- 30 automjete nga viti 2015; dhe
- 119 tjera gjatë vitit 2016.

Vonesat në riparime janë si rezultat i mungesës së pjesëve, stafit jo të mjaftueshëm dhe vjetërsisë së automjeteve.

Në anën tjetër PK vetëm gjatë vitit 2016 ka blerë automjete të reja në vlerë 1,894,170€. Vlen të theksohet që në kampin Vrella të PK-së, ishin në proces të shitjes 126 automjete, ndërsa edhe 325 automjete tjera ishin propozuar për t'u shitur.

Rreziku Dobësitë në vazhdimësi të automjeteve që presin për servisim, tregon se kontrollet ende nuk kanë arritur nivelin e duhur. Kjo rrit rrezikun e menaxhimit jo të mirë, zhvlerësimin në pritje të automjeteve dhe humbjes së pjesëve të tyre.

Rekomandimi 15 Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e PK-së duhet të rishikojnë arsyet për mos zbatimin rekomandimeve të AP-së (në tri vitet e fundit) dhe të përcaktojnë masa shtesë për të forcuar kontrollet në këtë njësi. Njëherit të forcojnë kontrollet prej identifikimit të defekteve e deri te riparimi i tyre, duke siguruar shfrytëzim më efikas të automjeteve.

3.3 Obligimet e papaguara

Në pasqyrat financiare vjetore të MPB-së për vitin 2016 obligimet e papaguara ishin në vlerë 1,688,956€ (përfshirë obligimet e MPB-së, PK-së, IPK-së dhe AKSP-së). Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2017. MPB kishte arritur të raportoj me kohë lidhur me obligimet e papaguara, mirëpo cilësia e raportimit nuk ishte e mirë. Kjo është prezantuar të çështja në vijim.

Çështja 16 - Raportim jo i drejtë i obligimeve të papaguara - Prioritet i mesëm

E gjetura Ne testuam mënyrën e raportimit të obligimeve të papaguara duke filluar nga protokollit, raportimi e deri te pagesa e obligimeve dhe anasjelltas. Lidhur me këtë kemi vërejtur se:

- Katër (4) pagesa në vlerë 100,180€ nuk janë raportuar drejtë në raportet mujore për obligimet e papaguara; dhe
- Raporti i obligimeve të papaguara për muajin shkurt i dorëzuar në MF ishte 531,476€, mirëpo në këtë raport nuk janë përfshirë dy fatura në vlerë prej 56,990€.

Kjo ka ndodhur pasi zyrtari përgjegjës raportonte vetëm pagesat që kalonin periudhën 30 ditë nga data e protokollit.

Rreziku Mos raportimi i saktë i obligimeve mujore rrit rrezikun që faturat të mos identifikohen dhe të mos paguhen me kohë, si dhe ekspozohet para ndëshkimeve të mundshme nga furnitorët.

Rekomandimi 16 Ministri në bashkëpunim më Drejtorin e PK-së duhet të sigurojnë kontrolle shtesë në raportimin e obligimeve, ashtu që vlerat e sakta të raportohen për periudha kohore dhe të përcillen nga muaji në muaj derisa të paguhen ato.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Ministri dhe Drejtorët e Përgjithshëm duhet të sigurojnë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm (AP), me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Përkundër progresit në zbatimin e rekomandimeve të AP-së, tetë (8) prej tyre kanë mbetur të pa zbatuara.	
2.5.2 Vlerësimi i rrezikut	Ministri dhe Drejtorët e Përgjithshëm të Agjencive duhet të sigurojnë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës dhe të sigurojnë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar.		MPB ka hartuar regjistrin e rreziqeve, mirëpo jo edhe agjencitë ekzekutive të saj.	
3.4 Prokurimi	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të sigurojnë se Departamenti i prokurimit ka bërë një analizë të mirëfilltë para procesit të planifikimit në mënyrë që kërkesat për shërbimet e njëjta të tenderohen përmes procedurave të kontratave kornizë. Kjo njëkohësisht do të shmang edhe kërkesat e shumta administrative që kanë të bëjnë me lidhjen e disa kontratave me kuotim të çmimeve.	Po		
3.4 Prokurimi	Ministri dhe Drejtorët Ekzekutiv duhet të sigurojnë se kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave janë duke u monitoruar në vazhdimësi. Prosesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPF-në, dhe me rregullat e Thesarit.			Nuk është zbatuar.

3.4 Prokurimi	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të sigurojnë se janë forcuar edhe me tej kontrollet në proceset e planifikimit (analizë e pengesave të mundshme), monitorimit dhe realizimit të projekteve kapitale, në mënyrë që të respektohet afati për përmbushjen e kontratës.			Nuk është zbatuar.
3.4 Prokurimi	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të sigurojnë mbikëqyrje të rregullt të procesit të realizimit të buxhetit, me qëllim që çdo faturë të paguhet brenda afatit të përcaktuar ligjor.			Nuk është zbatuar.
3.4 Prokurimi	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së, duhet të sigurojnë kontrole shtesë te njësitë kërkuese, në mënyrë që kërkesat të jenë të strukturuar mirë (të qarta dhe të sakta). Gjithashtu duhet të sigurojë se Zyrtari Çertifikues si funksion kyç i sistemit të kontrollit, të kontrolloj të gjitha pagesat për të verifikuar nëse ato janë në pajtim me kontratat.	Po		
3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Ministri në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm duhet të sigurojnë se janë marrë masa për të ndërprerë praktikën e lidhjes së kontratave pa procedura të rekrutimit, si dhe të sigurojnë se në buxhetin e viteve në vijim në kategorinë paga dhe mëditje përfshihen pagat e të gjithë të punësuarve të nevojshëm, si dhe të gjitha pagesat për pagat e tyre të kalojnë përmes sistemit të pagave.			Nuk është zbatuar.
3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të rishikojnë arsyet për mos adresimin e rekomandimeve të AP-së dhe të përcaktoj kontrole shtese në menaxhimin e procedurave të rekrutimit. Procedurat e rekrutimit duhet të fillojnë me kohë, dhe kohëzgjatja e funksionit si ushtrues detyre të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar me Udhëzimin Administrativ.			Nuk është zbatuar.

3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm duhet të sigurojnë se janë parandaluar të gjitha pagesat të cilat janë në kundërshtim me vendimet e Qeverisë. Informatat lidhur me të ardhurat nga burimet tjera mund të merren nga zyrtarët e MF-së të cilat janë përgjegjës për menaxhimin e listës së pagave.	Po		
3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të shqyrtojnë shkaqet e mos adresimit të këtij rekomandimi në vazhdimësi dhe të përcaktojnë kontrole shtesë në menaxhimin e Burimeve Njerëzore për të siguruar azhurnim të rregullt të dosjeve të personelit, si dhe vlerësim të rregullt vjetor për të gjithë të punësuarit.	Po		
3.5.2 Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të shqyrtoj rastet e lartpërmendura për t'i hetuar shkaqet e mos realizimit të objektivave dhe të sigurojë se kontrole shtesë në këtë drejtim. Përkrahja financiare e projekteve duhet të përcillet përmes procedurave përkatëse të monitorimit për të siguruar se janë realizuar objektivat e shpenzimeve në këtë kategori.			Nuk është zbatuar.
3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo- kapitale	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të rishikojnë arsyet për mos adresimin e rekomandimeve të AP-së dhe të përcaktojnë masa shtesë për të forcuar kontrollet në këtë njësi. Kontrollat duhet të përfshijnë gjithë procesin prej identifikimit të defekteve e deri te riparimi i tyre. Kjo do të eliminonte pritjet e gjata të automjeteve dhe do të siguroj shfrytëzim me efikas të tyre.			Nuk është zbatuar.

3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri në bashkëpunim me Drejtorët e Agjencive (PK dhe IPK) duhet të sigurojnë kontrole funksionale në menaxhimin e pasurisë për të mundësuar azhurnimin e rregullt të regjistrave të tyre, përfshirë edhe procesin e inventarizimit (krahasimi i regjistrave të pasurisë me gjendjen e tyre fizike). Ndërsa për pasuritë e përdorura të pranuar si donacion, duhet të behët një komision për të vlerësuar gjendjen e tyre dhe bazuar në konkluzionin e nxjerrë nga komisioni, menaxhmenti të merr vendim për formën e përdorimit të tyre.	Po		
3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të sigurojnë se procesi i inventarizimit të pasurisë është përfunduar dhe raportuar në kohë të përshtatshme para përgatitjes së PVF-ve. Të gjitha ndryshimet e identifikuar nga ky proces përfshirë vlerën dhe numrin e pasurisë të prezantohen në regjistrat e pasurisë (regjistrin kontabël dhe sistemin E-Pasuria).	Po		
3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të AKSP duhet të sigurojnë se menaxhimi dhe raportimi i pasurisë bëhet në përputhje me kërkesat e dala nga rregullorja mbi menaxhimin e pasurisë. Lidhur me këtë duhet të vazhdojnë përpjekjet që në bashkëpunim me MAP-in të funksionalizojnë sistemin e-pasuria.	Po		
3.7.2 Trajtimi i borxheve	Ministri në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm dhe Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të sigurojnë kontrole shtesë në menaxhimin e obligimeve. Vlerat e sakta të obligimeve duhet të përcillen nga një muaj në tjetrin, në përputhje me kërkesat ligjore. Për më tepër, të gjitha masat e nevojshme duhet të merren për forcimin e kontroleve për këto procese.			Nuk është zbatuar.

Shtojca IV: Letërkonfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS-ALTIJA E KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME / MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS	
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelaria Stalnoe Sekretara Office of the Secretary General	
No. Sh. / No.	433
Data / Datum / Date	07.06.2017
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA	

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME / MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA/
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS

ZYRA E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM/ KANCELARIA STALNOG SEKRETARA
OFFICE OF THE SECRETARY GENERAL

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin
2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit (Pasqyrave) Financiar të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Lulzim Bashi

Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme,

Data: 07 Qershor 2017, Prishtinë.

Faqe 1 nga 1